



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 621 Akti

Nr. 680 Vendimi
Tiranë, më 21.6.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idriqi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Francesco Ciardi, në datën 21.6.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Ejona Lazellari**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Xhensila Pine dhe Alma Faskaj. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 22.12.2020, u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Xhensila Pine, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari.

5. Në vijim, për shkak se në shortin e muajit qershor 2020, komisionerja Alma Faskaj ka qenë shortuar si anëtare trupe në çështjen e subjektit L.F, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, në respektim të garantimit të paanshmërisë së gjykimit dhe vendimmarrjes mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt dhe marrjen e masave për shmangien e rrethanave që përbëjnë konflikt interesi, si dhe vlerësimin tërësisht të ndryshëm të subjekteve që kanë lidhje familjare midis tyre, në datë 21.1.2021, ka paraqitur kërkesë për dorëheqje si anëtare e trupit gjykues për kryerjen e procesit të rivlerësimit të subjektit Ejona Lazellari, si çështje që është e shpërndarë e dyta në radhë. Kjo kërkesë u shqyrtua dhe u pranua nga një tjetër trupë gjykuese¹. Si rrjedhojë, pjesë e trupit gjykues për procesin e rivlerësimit të subjektit Ejona Lazellari u bë anëtarja zëvendësuese, znj. Brunilda Bekteshi, e cila deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit.

6. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

7. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

¹ Vendim i datës 2.2.2021, i trupit gjykues të përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Olsi Komici dhe Etleda Çiftja, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.2.2021.

8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

10. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

11. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin² e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

12. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin³ e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport⁴ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

14. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

15. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 13.6.2023, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari; (ii) njoftimin e

² Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë me nr. *** prot., datë 6.2.2018.

³ Raporti mbi kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 31.10.2017.

⁴ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale me nr. *** prot., datë 30.6.2021.

subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

16. Subjekti i rivlerësimit, në datën 13.6.2023, u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 15.6.2023, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve në datën 19.6.2023, në rrugë elektronike, me *email*.

17. Pas shqyrtimit të shpjegimeve të vëna në dispozicion, trupi gjykses vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *email*, në datën 19.6.2023.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 21.6.2023, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

18.1 Subjekti i rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Znj. Ejona Lazellari ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke iu përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

19.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.4 Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

20.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁵ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar *Vetting*”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

22.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari.

⁵“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

22.2 Në deklaratën *Vetting* (shtojca ***), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron këto pasuri:

23. Pasuria e llojit apartament banimi, me sipërfaqe 66 m² dhe verandë 34.56 m², ndodhur në Tiranë, blerë në datën 6.3.2014, me vlerë 55,000 euro, në bashkëpronësi me bashkëjetuesin.

23.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) shumën 40,000 euro (vlera ekuivalente 5,640,000 lekë) përfituar nga kredia bankare e marrë në Societe Generale Albania, sipas kontratës së datës 17.3.2014 (shlyerja e kredisë me të ardhurat e përfituara nga babai i saj, si rezultat i shitjes së një apartamenti, në datën 25.3.2010, konfirmuar prej tij dhënia e kësaj shume, me deklaratën e datës 10.10.2016); (ii) shumën 15,000 euro, me burim të ardhurat e përfituara nga babai, si rezultat i shitjes së një apartamenti, në datën 25.3.2010, konfirmuar prej tij dhënia e kësaj shume, me deklaratën e datës 10.10.2016.

23.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Komisioni konstaton se në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë (në vijim DIPP) të vitit 2014, subjekti ka deklaruar këtë pasuri, duke referuar të njëjtat të dhëna dhe burime të krijimit të saj sikurse ka deklaruar edhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të evidentuara si më sipër, duke specifikuar se shuma prej 15,000 euro disponohej prej saj si pjesë e të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit prej babait të saj (e referon si banesë të përbashkët), në mars të vitit 2010.

23.3 Konstatimi i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjet e ardhura nga institucionet përkatëse.

23.4 Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

23.4.1 Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit mbi mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe pagesat e kryera në funksion të shlyerjes së çmimit të blerjes së saj⁶, Komisioni konstaton se:

i. Në datën 6.3.2014 është nënshkruar kontrata e shitjes⁷ mes subjektit të rivlerësimit, bashkëjetuesit të saj, z. L.F, në cilësinë e palës blerëse dhe znj. Xh.Rr, në cilësinë e palës shitëse, me objekt shitblerjen e pasurisë së llojit apartament banimi nr. ***, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sipërfaqe 66.6 m² dhe sipërfaqe verande 34.56 m², të ndodhur në katin e pestë të godinës 9-katëshe, shkalla nr. ***, në rrugën “****”, Tiranë, kundrejt çmimit 55,000 euro. Në këtë kontratë, plani i pagesave është përcaktuar si vijon: (1) në datën e nënshkrimit të kontratës (datë 6.3.2014) do të likuidohen 15,000 euro pranë bankës Societe Generale Albania, në numrin e llogarisë së palës shitëse; (2) me përfitimin e kredisë nga pala blerëse në shumën prej 40,000 euro, kjo shumë do të kalojë po në të njëjtën llogari të palës shitëse, pranë Societe Generale Albania.

ii. Në datën 6.3.2014, personi i lidhur, z. L. F (në atë periudhë bashkëjetuesi i subjektit), ka depozituar në llogarinë dyemërore në Societe Generale Albania (sot OTP Bank) shumën prej 15,000 euro, me përshkrimin “Derdhje *cash*”. Në të njëjtën datë, kjo shumë është transferuar në favor të palës shitëse të pasurisë objekt vlerësimi, znj. Xh.Rr, me përshkrimin “Pague nga L.F dhe Ejona Lazellari në bazë të kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., për blerje apartamenti”.

⁶ (i) Shkresa e ASHK - Drejtoria Vendore Tirana Jug, me nr. *** prot., datë 14.9.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.9.2020), pjesë e dosjes së hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për personin e lidhur, subjektin e rivlerësimit, z. L.F; (ii) dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së; (iii) shkresa e OTP Bank (ish-Societe Generale Albania) me nr. ***, datë 2.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.2.2021); (iv) dokumentacioni i përcjellë me shkresën e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë 8.5.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.5.2023), etj.

⁷ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.3.2014, redaktuar nga noteri publik, znj. A.K.

iii. Në datën 26.3.2014, në llogarinë dyemërore të subjektit dhe personit të lidhur në Societe Generale Albania (sot OTP Bank), janë disbursuar fondet e kredisë bankare, të përfituara sipas kontratës së datës 17.3.2014, në shumën 5,620,000 lekë (ekuivalenti i vlerës në valutë prej 40,000 euro) dhe se në po të njëjtën datë kjo shumë është transferuar në llogarinë bankare të shitëses së pasurisë objekt vlerësimi, znj. Xh.Rr, me përshkrimin “Në favor të Xh.Rr, xhirim me kurs 140.5”.

iv. Në datën 15.4.2014, pasuria objekt vlerësimi, apartamenti me sipërfaqe 66.6 m², ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, është regjistruar në Regjistrin Hipotekor në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, z. L.F⁸.

24. Analiza dhe verifikimi i të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe/apo personit të lidhur, të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie

24.1 Sikurse u evidentua edhe më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit të ndodhur në rrugën “ *** ”, Tiranë, kanë shërbyer: (i) shuma prej 15,000 euro, me burim të ardhurat e përfituara nga babai, si rezultat i shitjes së një apartamenti në datën 25.3.2010; dhe (ii) shuma prej 40,000 euro (vlera ekuivalente 5,640,000 lekë), përfitur nga kredia bankare e marrë në Societe Generale Albania, sipas kontratës së datës 17.3.2014.

i. Shuma prej 15,000 euro, me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit të babait/familjes

Komisioni konstaton se në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (dorëzuar në datën 13.1.2014 në ILDKPKI, data e fillimit të detyrës 21.11.2013), në seksionin “Deklarimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumë të hollash në vlerën 60,000 euro, por duke mos deklaruar specifikisht burimin e krijimit të kësaj shume, nëse këto likuiditete disponoheshin në gjendje *cash* apo në llogari bankare dhe pjesën në përqindje që zotëronte. Por, nga ana tjetër, rezulton se ka referuar si dokument justifikues të depozituar në ILDKPKI për krijimin e kësaj shume “kontratën e shitblerjes së apartamentit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.3.2010, notere I.Sh”, duke shënuar gjithashtu në këtë deklaratë “nga babai”.

Ndërsa, në DIPP/2014, në referimin e burimeve të krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, ndër të tjera, duket se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “...15 (pesëmbëdhjetë) mijë euro të cilat i ka disponuar dhe që burimi i krijimit është babai i saj; është shitur apartamenti, banesë e përbashkët (kontrata e shitblerjes së apartamentit me nr. *** rep., nr. *** kol., e datës 25.3.2010, pranë noteres I.Sh, dokument i cili është vënë në dispozicion në momentin e deklaratës fillestare).”

Referuar këtyre deklarimeve, rezulton se si burim për shlyerjen e këstit të parë të pasurisë objekt vlerësimi, e konkretisht për pagesën e kryer në datën 6.3.2014, në shumën 15,000 euro, kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga babai (familja) i subjektit, si rezultat i shitjes së pasurisë së llojit apartament banimi, në datën 25.3.2010, pjesë e shumës prej 60,000 euro, deklaruar nga subjekti si pasuri e llojit likuiditet në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës.

Komisioni konstaton se bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka depozituar deklaratën e nënshkruar në datën 17.10.2016, nga babai i saj, z. G.L, para noterit publik në SHBA, shteti New Jersey, nëpërmjet së cilës, ndër të tjera, ka deklaruar se: “...Shuma prej 60,000 euro, e cila është deklaruar si pasuri e vajzës së tij, znj. Ejona Lazellari në deklaratën fillestare të pasurisë (tetor 2013), për të cilën ajo ka pasur të drejtën e administrimit dhe e cila buron nga kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.3.2010, i kalon në

⁸ Referuar dokumentit – “Vërtetim nga dokumentet hipotekore”, datë 15.4.2014.

*pronësi të plotë, pa kufizim tagrash, vajzës së tij, znj. Ejona Lazellari, duke u zhveshur ai, deklaruesi G.L, nga çfarëdo e drejtë apo pretendimi në lidhje me këtë shumë”. Gjithashtu, nëpërmjet këtij dokumenti noterial, z. G. L, deklaroi se *njih dhe konfirmon të gjitha deklaratimet e vajzës së tij në lidhje me raportimet në deklaratat e pasurisë së saj.**

Pasi Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë mbi faktin e deklaratimit të shumës prej 60,000 euro si pasuri vetjake të saj, ndërkohë që duket se në momentin e deklaratimit ka pasur vetëm të drejtën e administrimit të kësaj shume, si dhe të deklarojë nëse ka marrë autorizimin e babait të saj për përdorimin e shumës prej 15,000 euro, për shlyerjen në datën 6.3.2014 të kështit të parë për blerjen e apartamentit, pasurisë objekt vlerësimi⁹, ndër të tjera, ajo deklaroi se, *në lidhje me deklaratimet mbi këtë pasuri (i referohet shumës prej 60,000 euro) është përpjekur të pasqyrojë çdo pasuri që posedon, administron, gëzon, duke deklaruar edhe burimet konkrete të pasurive. P.sh. Në të njëjtën mënyrë, ka deklaruar të ardhurat mujore edhe nga qiraja, edhe pse kontrata e qirasë ka qenë në emër të nënës dhe babait të saj. Pra është një deklaratim, për çdo pasuri që ka lidhje me atë si subjekt i deklaratimit... Në lidhje me përdorimin e shumave, bën me dije se janë kryer me vullnetin, pëlqimin dhe autorizimin e babait.*

Për sa më sipër, bazuar në pikën 14 të nenit 3 dhe pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi G.L bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 60,000 euro, deklaruar nga subjekti në deklaratën fillestare të pasurisë, konfirmuar si shumë e dhuruar prej tij.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje¹⁰, konfirmohet se, **në datën 25.3.2010**, babai i subjektit, në cilësinë e palës shitëse dhe nëna e subjektit, si dhënëse e pëlqimit, i kanë shitur¹¹ shtetasit M.H pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe 97 m², ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, për shumën 16,975,000 lekë¹². Gjithashtu, nga hetimi i kryer rezultoi se pasuria e sipërcituar ishte blerë¹³ më parë nga babai i subjektit,¹⁴ në datën 13.4.2002, nga shoqëria “****” sh.p.k., për shumën 55,000 euro, periudhë në të cilën subjekti i rivlerësimit ka qenë e mitur.

Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të babait të subjektit, z. G.L, në Intesa Sanpaolo Bank¹⁵, konstatohet se **në datën 2.4.2010**, në llogarinë e tij në valutë është kredituar shuma prej 122,000 euro, me përshkrimin: “*Transfer M.H fav. G. R. L, pagesë për blerje apartamenti, rr. “****”, p. “****”, shkalla ****, ap. *****”. Në vijim të verifikimit të lëvizjeve të kësaj llogarie, rezultoi se kjo shumë është debituar plotësisht gjatë vitit 2010, duke u kryer disa tërheqje dhe transfera të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur, si vijon: (i) vlera prej 106,938 euro është tërhequr *cash*, nga të cilat: (a) shuma prej 49,938 euro pa përshkrim; (b) shuma prej 15,000,

⁹ Pyetja nr. ***, nënpyetjet *** dhe *** të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

¹⁰ Dokumentacion i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

¹¹ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol, datë 25.3.2010, redaktuar nga noteri publik, znj. I.Sh.

¹² Nga verifikimi i kryer në sistemin multifunksional të ASHK-së, rezultoi se kjo pasuri të jetë e regjistruar në emër të blerësit M.H, fletë e printuar nga ky sistem, pjesë e dosjes së hetimit administrativ të kryer për personin e lidhur, subjektin e rivlerësimit L.F.

¹³ Referojuni dokumentit “Kontratë shitjeje” nr. *** rep., nr. *** kol, datë 13.4.2002, dërguar nga noteri publik, znj. I.Sh, me shkresën e datës 21.11.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.11.2022, pjesë e dosjes së hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për personin e lidhur, subjektin e rivlerësimit, z. L.F.

¹⁴ Në këtë kontratë emri i babait të subjektit figuron të jetë V (sot është G), ndërsa gjeneralitetet e tjera janë të njëjta. Nga DPGJC-ja konfirmohet se shtetasi G.L, në datën 21.2.1992, ka ndryshuar emrin nga “G” në “V” dhe më pas, në datën 17.5.2005, ka ndryshuar përsëri emrin nga “V” në “G” (referojuni shkresës së DPGJC-së me nr. *** prot., datë 18.11.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 22.11.2022, pjesë e dosjes së hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për personin e lidhur, subjektin e rivlerësimit, z. L.F).

¹⁵ Shkresë e ISP Bank, me nr. *** prot., datë 9.2.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.2.2021.

me përshkrimin “Për pagesa”; dhe (c) shuma prej 42,000 euro me përshkrimin “Kthim detyrimi”; (ii) vlera prej 15,000 euro është transferuar në një llogari tjetër, me përshkrimin “Kthim detyrimi te A.L”.

Sa më sipër, Komisioni konstaton se babai i subjektit, z. G. L /prindërit e saj, ka/kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht krijimin e shumës prej 60,000 euro, të deklaruar nga subjekti në deklaratën fillestare të pasurisë, konfirmuar si shumë e dhuruar nga personi tjetër i lidhur, një pjesë e së cilës, shuma prej 15,000 euro, është deklaruar si burim për shlyerjen e kështit të parë të çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

ii. Shuma prej 40,000 euro, përfituar nga kredia bankare në SGA Bank (sot OTP Bank)

Nga verifikimi i informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga OTP Bank (ish-SGA Bank)¹⁶, konfirmohet se **në datën 17.3.2014**, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, z. L.F, në cilësinë e kredimarrësve, kanë lidhur “kontratën e kredisë bankare afatgjatë për shtëpi”¹⁷, në të cilën përcaktohet se banka i jep kredimarrësve një kredi në shumën prej 5,640,000 lekësh, për blerje apartamenti, për një periudhë prej 240 muajsh (20 vite). Rezulton se për garantimin e shlyerjes së kësaj kredie është vendosur si kolateral pikërisht apartamenti objekt transaksioni, pra pasuria për të cilën janë kërkuar e në vijim lëvruar fondet e kësaj kredie, me qëllim blerjen e saj nga kredimarrësit, e cila në momentin e lidhjes së kontratës së kredisë ka qenë në pronësi të shitëses, shtetas Xh.Rr¹⁸.

Komisioni konstaton se, në DIPP/2014, në seksionin “Detyrimet Financiare ndaj Personave Juridike dhe Fizike”, subjekti ka deklaruar këtë kredi bankare, të dhënat lidhur me të, shumën e shlyer gjatë vitit dhe gjendjen e detyrimit të mbetur në fund të vitit.

Siç u evidentua edhe më sipër, **në datën 26.3.2014**, në llogarinë dyemërore të subjektit dhe personit të lidhur në Societe Generale Albania (sot OTP Bank), janë disbursuar fondet e kredisë bankare të përfituar sipas kontratës së datës 17.3.2014, në shumën prej 5,620,000 lekësh (ekuivalenti i vlerës në valutë prej 40,000 euro) dhe se, në po të njëjtën datë, kjo shumë është transferuar në llogarinë bankare të shitëses së pasurisë objekt vlerësimi, znj. Xh.Rr, me përshkrimin “Në favor të Xh.Rr, xhirim me kurs 140.5”.

Sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e bëra nga subjekti në ILDKPKI, si dhe shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, rezulton se fondet e përfituara nga kredia e marrë në Societe Generale Albania kanë shërbyer për likuidimin e plotë të çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

Pas kalimit të shumës së përfituar nga kredia në favor të palës blerëse, **në datën 31.3.2014**, me anë të një deklarate noteriale, banka jep pëlqimin për kalimin e pronësisë së apartamentit, objekt transaksioni/vlerësimi nga shtetasja Xh.Rr tek shtetasit L.F dhe Ejona Lazellari, me kushtin që prona të vijojë e rënduar me barrën hipotekore në favor të bankës.

Në vijim të verifikimit të lëvizjeve të llogarisë dyemërore të subjektit dhe personit të lidhur në OTP Bank (ish-SGA Bank), llogaria e kredisë, konstatohet se gjatë periudhës **27.3.2014 – 10.10.2016** janë kryer pagesa për likuidim kështesh kredie dhe shpenzime të tjera të lidhura me të, në shumën totale prej 1,292,055 lekësh.

¹⁶ Shkresë e OTP Bank (ish-Societe Generale Albania) me nr. *** prot., datë 2.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.2.2021).

¹⁷ “Kontratë kredi bankare afatgjatë për shtëpi”, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.3.2014, redaktuar nga noteri publik, znj. A. K.

¹⁸ Referojuni dokumentit “Kontratë Hipotekimi”, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.3.2014, redaktuar nga noteri publik, znj. A.K.

Rezulton se, në datën 7.10.2016, personi i lidhur, z. L.F, ka depozituar *cash* në llogarinë e tij në euro pranë OTP Bank, shumën prej 40,000 euro, me përshkrimin “Derdhje cash”, shumë e cila në datën 10.10.2016 është kaluar në llogarinë dyemërore, e cila shërbente për shlyerjen e kredisë, konvertuar në vlerën 5,476,000 lekë, me përshkrimin “Këmbim në llogari”. Në vijim, në datën 11.10.2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë shlyer para kohe të gjithë shumën e mbetur të kredisë, prej 5,369,316 lekësh¹⁹.

Komisioni konstaton se, në DIPP/2016, në seksionin “Detyrimet Financiare ndaj Personave Juridikë dhe Fizikë”, subjekti ka deklaruar shlyerjen e plotë të kësaj kredie bankare, në shumën prej 5,369,317 lekësh, me burim të ardhurat e realizuara nga babai i saj, z. G.L, të përfituara nga shitja e apartamentit në datën 25.3.2010, konfirmuar me deklaratën e bërë prej tij, në datën 10.10.2016²⁰. Gjithashtu, rezulton se edhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka referuar se shlyerja e kredisë bankare në tetor të vitit 2016, ka si burim të ardhurat e përfituara nga babai i saj, si rezultat i shitjes së një apartamenti në datën 25.3.2010 (konfirmuar prej tij dhënia e kësaj shume me deklaratën e datës 10.10.2016).

E pyetur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ²¹, duke i kërkuar të shpjegojë mbi arsyen e marrjes së kredisë prej saj dhe bashkëjetuesit, për sa kohe duket se ajo dispononte një vlerë të konsiderueshme monetare *cash*, pjesë e mbetur të shumës prej 60,000 euro, deklaruar në deklaratën interesave privatë para fillimit të detyrës, referuar si e dhuruar nga babai, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“...Në lidhje me arsyen e marrjes së kredisë, bën me dije se fondi 60,000 euro dhe administrimi i tij është çështje personale dhe familjare e familjes së origjinës, plane të cilat kanë ndryshuar në varësi të situatave faktike. Është vlerësuar të mos shpenzohej e gjithë shuma, nevoja për likuiditete në lidhje me planifikime të tjera familjare të cilat nuk janë realizuar (blerja e një garazhi dhe automjeti). Ndërkohë, shlyerja e kredisë përkon me realizimin e kontratës së shitjes të objektit të lëshuar me qira nga prindërit, si dhe dhënien e deklaratës konfirmuese në tetor të vitit 2016, situatë faktike që ka krijuar likuiditete në sistemin bankar. Ky apartament është vendi ku prindërit kanë qëndruar në Shqipëri, pra ka si qëllim shfrytëzimin e përbashkët”*.

Në vijim të verifikimeve të kryera, lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, rezulton se nëpërmjet dokumentit noterial të datës 28.10.2016²², Societe Generale Albania (sot OTP Bank) ka konfirmuar se kredimarrësi (subjekti dhe personi i lidhur) e ka shlyer kredinë dhe nuk ka më detyrime ndaj bankës, e në këtë kuadër autorizon ZRPP-në të kryejë veprimet e nevojshme për lirim të pronës së sipërcituar (pasurisë objekt vlerësimi) nga barra hipotekore.

Pra, rezulton se kredia bankare, vlera e së cilës është përdorur për pagesën e këstit të dytë të pasurisë objekt vlerësimi, është shlyer me shumën prej 40,000 euro, pjesë e vlerës prej 60,000 euro, të deklaruar nga subjekti në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, me burim dhurimin nga babai/familja i/e saj, si dhe me të ardhurat e tjera të përfituara nga subjekti dhe personi i lidhur gjatë viteve 2014 – 2016. Pasi u verifikua ligjshmëria e burimeve financiare të babait/familjes së subjektit, në cilësinë e personit/personave tjetër/të tjerë të lidhur me të, Komisioni arriti në përfundimin se babai/familja i/e saj ka/kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të krijuara nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësonin plotësisht krijimin e shumës prej 60,000 euro, deklaruar dhe pranuar si e dhuruar në favor të subjektit.

¹⁹ Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“...Në lidhje me përdorimin e shumave janë kryer me vullnetin, pëlqimin dhe autorizimin e babait dhe se është vënë në dijeni në lidhje me deklaratën e datës 10.10.2016, deklaratë e cila është kryer për të konfirmuar deklaratimet e saj, në lidhje me deklaratimet pranë ILDKPI-së, deklaratimet në kuadër të procesit të rivlerësimit”*.

²⁰ I njëjti deklaram është bërë edhe nga bashkëjetuesi i subjektit në DIPP/2016.

²¹ Pyetja nr. *** e pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni.

²² Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2016.

Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e bëra ndër vite në ILDKPKI, si dhe shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për vitet 2014 – 2016, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit dhe personit të lidhur, për shlyerjen e kredisë bankare në SGA Bank (sot OTP Bank), të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1

Analiza financiare për vitet 2014 - 2016.	2014	2015	2016
A) Pasuri	7,413,383	488,309	-5,952,851
Apartament banimi në bashkëpronësi me bashkëjetuesin, blerë në dt.6.3.2014	7,700,000		
Automjet i markës ***, tip *** me targa TR ***në përdorim.			
Automjet i markës *** me targa AA ***, blerë nga b/shorti në datë 29.1.2016			400,000
Ndryshim likuiditeti	-286,617	488,309	-6,352,851
B) Detyrime	5,640,000	0	0
Kredi bankare për blerje pasurie të paluajtshme (OTP Bank)	5,640,000		
C) Pasuri neto (A-B)	1,773,383	488,309	-5,952,851
D) Të ardhura	4,148,174	2,273,020	2,032,015
Të ardhura nga paga e subjektit	976,835	979,108	1,052,201
Të ardhurat e subjektit nga magistratura		37,400	
Të ardhura nga paga e personit të lidhur	980,726	990,422	979,814
Të ardhura nga babai i subjektit	1,783,014		
Të ardhura nga babai i subjektit	407,599		
Të ardhura nga shitja e automjetit ***, targë AA*** (personi i lidhur)		139,450	
Të ardhura nga prindërit dhe motra e subjektit		126,640	
E) Shpenzime	2,326,909	1,350,327	6,386,578
Shpenzime minimale jetike	439,996	448,552	470,184
Shpenzime për udhëtimi jashtë vendit	760,978	152,491	176,607
Shpenzime qiraje, subjekti rivlerësimit, Tiranë	50,000		
Shpenzime qiraje, personi i lidhur, Vlorë	120,000	120,000	120,000
Shpenzime për arredim apartamenti në Tiranë	560,000	140,000	
Shpenzime shlyerje kredie (OTP Bank)	395,935	489,284	5,619,787
Balanca e fondeve (D-C-E)	47,883	434,383	1,598,287

24.2 Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura të krijuara nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht shlyerjen gjatë viteve 2014 – 2016, të vlerës së kredisë së marrë në SGA Bank (sot OTP Bank), e cila paraprakisht kishte shërbyer si burim për shlyerjen e këstit të dytë dhe përfundimtar (çmimit të plotë) të pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

24.3 Si konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e pasurisë objekt vlerësimi, si dhe ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht likuidimin e çmimit të blerjes së saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33 pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

25. Pasuri në përdorim, e llojit automjet i markës “**”, tip “****”**

25.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie, ka deklaruar: (i) kontratën e shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.4.2009; (ii) autorizimin me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.2010; dhe (iii) deklaratën konfirmuese të njëzuar, lëshuar në datën 10.10.2016.

25.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Në deklaratën e interesave privatë përpara fillimit të detyrës²³, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të drejtën e përdorimit të automjetit tip “****”, me targë TR ***, me vlerë 13,500 euro, me përshkrimin te seksioni i dokumenteve justifikuese, “Autorizim për përdorim automjeti i datës 17.9.2010, me nr. *** rep., nr. *** kol., notere Sh.Gj”.

²³ Deklaratë e dorëzuar në ILDKPKI në datën 13.1.2014.

25.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar.

25.4 Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

25.4.1 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me këtë pasuri²⁴, Komisioni konstaton se në datën 29.4.2009, babai i subjektit, z. G.L, ka blerë²⁵ automjetin e markës “***”, tip “***”, vit prodhimi 2005, për shumën prej 13,000 euro. Rezulton se, në datën 17.9.2010, shtetasi G.L ka shprehur vullnetin, duke autorizuar²⁶ subjektin e rivlerësimit ta përdorë automjetin e markës “***”, tip “***”, në pronësi të tij, për një periudhë kohe të pacaktuar, brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, Komisioni konstaton se me anë të deklaratës së datës 10.10.2016, të firmosur përpara noterit publik në SHBA, shteti New Jersey, z. G.L konfirmon deklaratimet në lidhje me përdorimin e automjetit tip “***”, referuar autorizimit të datës 17.9.2010. Gjatë hetimit administrativ subjekti ka deklaruar se prindërit e saj jetojnë jashtë Shqipërisë që prej muajit tetor 2010²⁷, çka konfirmohet nga të dhënat e sistemi TIMS mbi raportin e hyrjeve dhe daljeve të tyre në/nga territori/n shqiptar²⁸.

25.4.2 Ky automjet rezulton të jetë përdorur edhe nga personi i lidhur, z. L.F, pasi në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ të kryer ndaj tij, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni, ndër të tjera, ai ka deklaruar se, *duke filluar nga muaji gusht i vitit 2013 dhe deri në muajin tetor të vitit 2015, ka përdorur për arsye pune sendin e luajtshëm të llojit automjet, tip “***” me targë TR ***, i cili rezulton në pronësi të vjehrrit, z. G.L, i cili me anë të deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.2010, rezulton të ketë lëshuar autorizim përdorimi për bashkëshorten e tij, znj. Ejona Lazellari.*

25.4.3 Komisioni konstaton se kjo pasuri është blerë nga shtetasi G.L përpara se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur, z. L.F, të emëroheshin në detyrën e gjyqtarit. Gjithashtu, rezulton se periudha kur shtetasi G.L është larguar nga Shqipëria për të jetuar jashtë vendit përkon me momentin e lëshimit të autorizimit për përdorimin e kësaj pasurie nga subjekti. Në këtë kontekst, trupi gjykues nuk ka dyshime mbi këtë pasuri dhe faktin e përdorimit të saj nga subjekti i rivlerësimit.

25.4.4 Si konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e pasurisë në përdorim, automjetit të markës “***”, tip “***”, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

26. Pasuri e llojit likuiditet – shumë të hollash në vlerën 10,000 euro

26.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: (i) të ardhurat e krijuara nga kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.3.2010 (shitja e apartamentit), konfirmuar me deklaratën konfirmuese të njësuar, lëshuar në datën 10.10.2016; (ii) të ardhurat e krijuara nga kontrata e qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2010, me qira mujore 1,500 euro/muaj për familjen, e cila është revokuar në datën 4.8.2014 me deklaratën nr. *** rep.,

²⁴ Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacioni i përcjellë me shkresën e DPSHTRR-së, me nr. *** prot., datë 2.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 4.2.2021).

²⁵ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.4.2009, redaktuar nga noteri publik, z. R. K.

²⁶ Konfirmuar autorizimi para zyrës së noterit publik, znj. Sh.Gj, me “Autentifikim Nënshkrimi”, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.2010.

²⁷ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. *** të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni.

²⁸ Referojuni informacionit të përcjellë me shkresën e DPPSH-së, me nr. *** prot., datë 4.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 5.2.2021). Rezulton se shtetasit G.L dhe V.L kanë dalë nga territori shqiptar nga pika kufitare e Rinasit, në datën 22.9.2010. Hyrja më e afërt në territorin shqiptar për shtetasin G.L rezulton në datën 22.7.2012, ndërsa për shtetasen V.L, në datën 7.4.2011. Më tej, evidentohen hyrje-dalje të tjera, me periudha të shkurtra qëndrimi në territorin shqiptar. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionin të administruar në dosjen e hetimit administrativ, duket se prindërit e subjektit figurojnë të jenë rezident në SHBA.

nr.*** kol., të kredituara në llogarinë e babait të saj në Raiffeisen Bank, llogari në të cilën ajo kishte autorizim për kryerje transaksionesh²⁹; (iii) të ardhurat e transferuara në rrugë bankare nga babai, në llogarinë e tij në Raiffeisen Bank, llogari në të cilën ajo kishte autorizim për kryerje transaksionesh, me burim krijimi të ardhurat nga paga në SHBA, pasi është rezident³⁰.

26.2 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar.

26.3 Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

26.3.1 Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë mbi mënyrën e disponimit të kësaj pasurie. Por, nga ana tjetër, pas verifikimit dhe analizimit të dokumentacionit bankar të administruar në dosje, si edhe deklarimeve të bëra nga subjekti ndër vite në ILDKPKI, duket se vlera prej 10,000 euro pretendohet se disponohet si pasuri e llojit likuiditet në gjendje *cash*, në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

26.3.2 Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë, të depozituara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, sa i përket deklarimit të likuiditeteve gjendje *cash*, Komisioni konstaton se:

- **Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës³¹**, në seksionin “Deklarimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumë të hollash në vlerën 60,000 euro.

- **Në DIPP/2014**, në referimin e burimeve të krijimit të pasurisë së llojit apartament të blerë gjatë vitit 2014, Komisioni konstatoi se subjekti ka deklaruar përdorimin e shumës prej 15,000 euro, pjesë e shumës prej 60,000 euro të deklaruar më parë. Në deklaratet e bëra gjatë hetimit administrativ³², subjekti ka konfirmuar se shuma prej 60,000 euro, si vlerë fillestare e disponuar prej saj, është pakësuar në momentin e pagesës së këstit të parë për likuidimin e çmimit të blerjes së apartamentit në Tiranë, në mars të vitit 2014.

26.4 Pra, Komisioni arrin në përfundimin se në deklaratën e interesave privatë të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësimin e likuiditeteve *cash* në shumën prej 15,000 euro, nga totali i vlerës prej 60,000 euro, të deklaruar në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës.

26.5 Rezulton se, po në DIPP/2014, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjatë vitit 2014 ka tërhequr nga llogaria bankare në Raiffeisen Bank (nr. ***) e klientit G.L, ku ka pasur autorizim për tërheqjen e shumave nga babai i saj, shumat 8,346 euro dhe 7,000 USD. Gjithashtu, deklaroi se në këtë llogari, gjatë vitit 2014, ka derdhur shumën prej 1,600 USD.

26.6 Komisioni konstaton se, në DIPP/2014 subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të shumave të tërhequra nga llogaria bankare e babait dhe mbi destinacionin e tyre pas tërheqjes, si dhe nuk ka deklaruar burimin e krijimit të shumës prej 1,600 USD, të depozituar prej saj në llogarinë e babait.

26.7 Me anë të prapësimeve të dërguara, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se ka prezumuar deklarimin e burimit të krijimit, duke qenë se transaksionet kanë qenë bankare, ku mund të verifikohet se në llogarinë në euro të babait janë transferuar të ardhurat nga

²⁹ Konfirmuar nga babai subjektit me deklaratën noteriale të datës 10.10.2016.

³⁰ Konfirmuar nga babai subjektit me deklaratën noteriale të datës 10.10.2016.

³¹ Deklaratë e dorëzuar në ILDKPKI në datën 13.1.2014 (data e fillimit të detyrës 21.11.2013).

³² Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. ***.e) të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni.

qiradhënia dhe në llogarinë në dollarë, transferta është nga llogaria e pagës së babait nga puna në SHBA, burime për të cilat referon se ka depozituar dokumentacion ligjor provues.

26.8 Nisur nga fakti se këto vlera janë deklaruar në seksionin e ndryshimit të pasurive, ku pasqyrohen shtesat/pakësimet e pasurive, Komisioni vlerëson se ato përbëjnë shtesa dhe pakësim të likuiditeteve *cash* në vitin përkatës.

- Në **DIPP/2015**, në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, personi i lidhur ka deklaruar shumën prej 1,000 euro, me burim të ardhurat e krijuar nga shitja e automjetit, në datën 8.10.2015.

- Në **DIPP/2016**, në seksionin “Detyrimet Financiare ndaj Personave Juridike dhe Fizike”, subjekti ka deklaruar shlyerjen e plotë të kredisë bankare, në shumën prej 5,369,317 lekësh, me burim të ardhurat e realizuara nga babai i saj, z. G.L, të përfituara nga shitja e apartamentit, në datën 25.3.2010, konfirmuar me deklaratën e bërë prej tij, më 10.10.2016³³.

26.9 Siç u evidentua më sipër, në datën **7.10.2016**, personi i lidhur ka depozituar *cash* në llogarinë e tij në euro pranë OTP Bank, shumën prej 40,000 euro, me përshkrimin “Derdhje *cash*”, shumë e cila, në datën 10.10.2016, është kaluar në llogarinë dyemërore, e cila shërbente për shlyerjen e kredisë, konvertuar në vlerën 5,476,000 lekë, me përshkrimin “Këmbim në llogari”. Në vijim, rezultoi se në datën **11.10.2016**, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë shlyer para kohe të gjithë shumën e mbetur të kredisë prej 5,369,316 lekësh.

26.10 Në deklaratimet e bëra gjatë hetimit administrativ³⁴, subjekti ka konfirmuar se shuma prej 60,000 euro, si vlerë fillestare e disponuar prej saj, deklaruar në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, është pakësuar edhe në momentin e shlyerjes së plotë dhe të parakohshme të kredisë, në tetor të vitit 2016.

26.11 Sa më sipër, Komisioni konkludon se në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësimin e vlerës prej 40,000 euro, nga shuma e mbetur prej 45,000 euro, me burim të ardhurat e përfituara nga babai i saj prej shitjes së apartamentit në vitin 2010.

26.12 Vlen të evidentohet këtu se, përgjatë vitit 2016, subjekti ka shlyer edhe vlera të tjera që lidhen me kredinë e marrë në SGA Bank (sot OTP Bank), të cilat përfaqësojnë principalin dhe interesat e kësteve të kredisë deri në momentin e shlyerjes së plotë të saj, në datën 11.10.2016, në total shuma prej 406,823 lekësh.

26.13 Pra, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë vlerën e detyrimit të shlyer ndaj SGA Bank (sot OTP Bank) gjatë vitit 2016, por ka deklaruar vetëm detyrimin e shlyer në momentin e mbylljes së parakohshme të kësaj kredie.

26.14 Në prapësimet e saj lidhur me këtë konstatim, subjekti ka sqaruar se shuma tjetër e shlyer përbën vlerën totale të kaluar në formën e kësteve periodike gjatë vitit 2016, nga paga e bashkëshortit, z. L.F. Pra, rezulton se gjatë vitit 2016 është deklaruar se si ka ndryshuar llogaria e pagës nga pakësimet e ndryshme nga debitimet në këtë llogari. Në vijim, parashtron se mënyra e shlyerjes periodike të kredisë ka qenë objekt i vazhdueshëm dhe mund të konstatohet se kredia është mbajtur në pagën e bashkëshortit, situatë e cila nuk ka krijuar kursim, por pakësim të llogarisë së pagës në mënyrë periodike.

26.15 Referuar dokumentacionit bankar të administruar në dosje, konfirmohet se këstet e kredisë së marrë nga subjekti dhe personi i lidhur në SGA Bank (sot OTP Bank) janë likuiduar në mënyrë të vazhdueshme me fondet e transferuara nga llogaria e pagës së personit të lidhur në llogarinë dyemërore të kredisë.

³³ I njëjti deklaram është bërë edhe nga bashkëjetuesi i subjektit në DIPP/2016.

³⁴ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. ****.e) të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni.

26.16 Në vijim të verifikimit të deklarimeve mbi disponimin e likuiditeteve *cash*, rezulton se në DIPP/2016, në deklarinin e bërë veçmas, në seksionin “Ndryshimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, personi i lidhur, z. L.F, ka deklaruar pasurinë e llojit automjet, tip “***”, përfutur me kontratën e shitblerjes së datës 29.1.2016, me vlerë 400,000 lekë, me burim krijimi “Nga bashkëjetuesja, të ardhura të krijuara nga kontrata e qirasë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2010, me qira mujore 1,500 euro në muaj për familjen, e cila është revokuar në datën 4.8.2014, me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., nga ku në llogarinë bankare (nr. ***) të klientit G.L në Raiffeisen Bank, autorizohet tërheqja – deklaratë konfirmuese e njësuar, lëshuar në datën 10.10.2016”.

26.17 Edhe në deklarinimet e bëra gjatë hetimit administrativ³⁵, subjekti ka konfirmuar se në vitin 2016 ka pakësuar likuiditetet në shumën prej 400,000 lekësh, të përdorura për blerjen e automjetit tip “***”, nga personi i lidhur, z. L. F.

26.18 Pra, gjithashtu, Komisioni konkludon se në DIPP/2016 është deklaruar pakësimi i shumës prej 400,000 lekësh për blerjen e automjetit nga personi i lidhur, shumë e cila referohet se ka pasur si burim të ardhurat e tërhequra nga subjekti i rivlerësimit nga llogaria bankare e babait të saj, përfutur si rezultat i qiradhënies së disa pasurive të paluajtshme.

26.19 Bazuar në vetëdeklarinimet e bëra nga subjekti dhe personi i lidhur mbi shtesat/pakësimet/gjendjet e likuiditeteve *cash* ndër vite në ILDKPKI dhe vlerësimit të tyre në harmoni me shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, duket se ecuria e gjendjes së kursimeve në formë likuiditeteve *cash*, nga deklarata fillestare e pasurisë deri në DIPP/2016, paraqitet e pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 2

Viti	Deklaruar në DIPP	PERSONI I LIDHUR						Personi i lidhur (valutë EUR)		
		Valuta EUR			Valuta USD			Shtesë	Pakësim	Progresive
		Shtesë	Pakësim	Progresive	Shtesë	Pakësim	Progresive			
Para fillimit 2013	Personi i lidhur: Shumë të hollash në vlerën 60.000 euro	60,000 €	0 €	60,000 €	-	-	\$0	-	-	0 €
Vjetore 2013	Nuk janë deklaruar shtesa/pakësime/gjendje	-	-	60,000 €	-	-	\$0	-	-	0 €
2014	Lidhur me burimin e pasurisë apartament, personi i lidhur ka deklaruar: “[...] 15.000 euro të cilat i kam disponuar dhe që burimi i krijimit është babai im, është shitur apartamenti banesë e përbashkët [...]”	-	15,000 €	45,000 €	-	-	\$0	-	-	0 €
	Personi i lidhur: Gjatë vitit 2014 kam tërhequr, 8.346 euro dhe 7.000 dollarë, llogaria bankare nr.***, klienti G.R.L ku autorizohet tërheqja nga babai, pranë Raiffeisen Bank	8,346 €	-	53,346 €	\$7,000	-	\$7,000	-	-	0 €
	Personi i lidhur: Gjatë vitit 2014 kam derdhur 1.600 dollarë, llogaria bankare nr. *** klienti G. L	-	-	53,346 €	-	\$1,600	\$5,400	-	-	0 €
2015	Subjekti ka deklaruar në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimet e krijimit”: “Të ardhura të krijuara nga shitja e automjetit me kontratën me nr.*** kol., datë *** rep., datë 8.10.2015. Vlera 1.000 euro”.	-	-	53,346 €	-	-	\$5,400	1,000 €	-	1,000 €
2016	Lidhur me burimin e automjetit subjekti ka deklaruar [...] Nga bashkëjetuesja, të ardhura të krijuara nga kontrata e qirasë nr.*** rep, nr.*** kol, dt. 11.10.2010 [...]	-	2,885 €	50,461 €	-	-	\$5,400	-	-	1,000 €
	Subjekti dhe personi i lidhur: Shlyerje e kredisë bankare tetor 2016, të ardhura nga babai shtetasi G. R.L, të ardhura të krijuara nga kontrata e shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.3.2010, deklaratë konfirmuese e lëshuar në datë 10.10.2016, vlerë 5.369.316,9 lekë	-	40,000 €	10,461 €	-	-	\$5,400	-	-	1,000 €
Deklaruar në vetting				10,000 €			\$0			1,000 €
Diferenca				461 €			\$5,400			0 €

26.20 Referuar vetëdeklarinimeve të bëra, duket se në fund të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit dispononte gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën në valutë prej rreth 10,461 euro dhe 5,400 dollarë amerikan. Ndërkohë, në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, në datën 25.1.2017, duket se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon pasurinë e llojit likuiditeteve *cash* në vlerën prej 10,000 euro.

³⁵ Referojuni përgjigjes së pyetjes nr. ***.e) të pyetësorit nr. *** , të dërguar nga Komisioni.

26.21 Sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime shteruese mbi vetëdeklarimet e bëra ndër vite për likuiditetet *cash*, si dhe të deklarojë mbi destinacionin e shumave prej 461 euro dhe 5,400 dollarë amerikan, të cilat përfaqësojnë diferencën mes vlerës së likuiditeteve *cash* në valutë, të vlerësuara si gjendje në datën 31.12.2016, bazuar në vetëdeklarimet e bëra ndër vite në ILDKPKI dhe vlerës prej 10,000 euro, të deklaruar si gjendje likuiditetesh *cash* në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*.

26.22 Në prapësimet e saj, subjekti ka pranuar se ka pasur pasaktësi në deklarimin e pakësimeve të likuiditeteve *cash* ndër vite, por duke theksuar se ka deklaruar saktësisht gjendjen e likuiditeteve *cash* në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe se ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësonin plotësisht krijimin e kësaj shume.

26.23 Në vlerësimin përfundimtar të deklarimeve të bëra mbi disponimin e gjendjes së likuiditeteve *cash*, bazuar edhe në qëndrimin e konsoliduar të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, trupi gjykues vlerëson se pasaktësitë në deklaratat periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

27. Verifikimi dhe analizimi i ligjshmërisë së burimeve të deklaruara për krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën prej 10,000 euro

27.1 Siç u evidentua më sipër, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka referuar se si burim për krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën prej 10,000 euro, kanë shërbyer: (i) të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit prej familjarëve të saj në vitin 2010; (ii) të ardhurat nga qiradhënia e disa pasurive prej familjarëve të saj për vitet 2010 – 2014, të cilat i ka tërhequr nga llogaria bankare e babait në Shqipëri, sipas autorizimit të dhënë prej tij; dhe (iii) të ardhurat e përfituara prej babait të saj nga puna në SHBA, të transferuara në llogarinë e tij në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri, e në vijim të tërhequra nga subjekti bazuar në autorizimin e dhënë prej tij.

i. Të ardhurat familjare nga shitja e apartamentit në vitin 2010

Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës³⁶, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumë të hollash në vlerën 60,000 euro, të cilat, referuar deklarimeve të mëpashme të bëra nga subjekti në ILDKPKI dhe shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, kanë qenë të disponuara prej saj si pasuri në formë likuiditetesh *cash* dhe se me autorizimin e babait ka pasur të drejtën e përdorimit të tyre. Pra, deklarohet dhe konfirmohet se kjo shumë i është dhuruar subjektit nga babai/familja e saj. Në këtë kontekst, Komisioni e kategorizoi babain e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e personit tjetër të lidhur, i cili ka detyrimin për justifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurisë, e në këtë rast të shumës prej 60,000 euro, të deklaruar nga subjekti si pasuri në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezultoi e provuar se babai i subjektit, z. G.L, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësonin plotësisht krijimin e shumës prej 60,000 euro, të deklaruar nga subjekti në deklaratën fillestare të pasurisë.

Në vijim, rezultoi se subjekti ka deklaruar pakësimin e kësaj shume: (a) me 15,000 euro në vitin 2014 (deklarim i bërë në DIPP/2014), për pagesën e kështit të parë për likuidimin e çmimit të blerjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë; dhe (b) me 40,000 euro në vitin 2016 (deklarim i bërë në DIPP/2016) për shlyerjen e plotë të kredisë në SGA Bank (sot OTP Bank).

³⁶ Dorëzuar në datën 13.1.2014 në ILDKPKI (data e fillimit të detyrës 21.11.2013).

Sa më sipër, Komisioni konkludon se si burim krijimi të pasurisë objekt vlerësimi (shumës prej 10,000 euro *cash*) mund të ketë shërbyer vetëm vlera prej 5,000 euro nga të ardhurat e përfituara si rezultat i shitjes së apartamentit nga familjarët e saj në vitin 2010.

ii. Të ardhurat familjare nga qiradhënia

Komisioni konstatoi se në DIPP/2014 subjekti ka deklaruar se ka tërhequr nga llogaria bankare në Raiffeisen Bank të klientit G.L shumën 8,346 euro, e cila u vlerësua se disponohej si pasuri e llojit likuiditet në gjendje *cash* në fund të vitit 2014. Në referim të deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ dhe dokumentacionit të depozituar në këtë kuadër, rezulton se kjo vlerë monetare ka pasur si burim të ardhurat e përfituara nga familja e saj si rezultat i qiradhënies së disa pasurive të paluajtshme.

Gjithashtu, rezulton se nëpërmjet deklaratës së nënshkruar në datën 17.10.2016, para noterit publik në SHBA, shteti New Jersey, babai i subjektit, z. G.L, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“...Shumat e parave në euro dhe USD, të cilat kanë qenë objekt i deklaramit të pasurisë nga vajza e tij, për të cilat ajo ka pasur të drejtën e administrimit dhe tërheqjes dhe të cilat kanë rrjedhur si rezultat i kontratës së qirasë lidhur me subjektin “****” sh.p.k. dhe transfertat nga të ardhurat familjare në SHBA, si dhe nga derdhjet e kryera në llogarinë e tij rrjedhëse në Raiffeisen Bank, konsiderohen pjesë e pasurisë së vajzës Ejona Lazellari, pa asnjë kufizim tagrash pronësie, duke u zhveshur ai nga çfarëdo e drejtë apo pretendim në lidhje me këto shuma”*.

Bazuar në pikën 14 të nenit 3 dhe në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi G.L bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 8,346 euro, deklaruar nga subjekti në DIPP/2014, konfirmuar si shumë e dhuruar nga babai i saj.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se në datën 11.10.2010, shtetasi G dhe V.L, të përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit³⁷, kanë lidhur kontratën e qirasë³⁸ me shoqërinë “****” sh.p.k.,³⁹ duke i dhënë me qira kësaj të fundit objektet: 1. *Ndërtesë, magazinë ambalazhi qelqi me sip. 450 m² dhe truall me sip. 450 m², rr. “****”, Tiranë, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, Tiranë; 2. Truall me sip. 629 m², rr. “****”, Tiranë, i regjistruar me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, Tiranë; 3. Truall me sip. 243 m², rr. “****”, Tiranë”, me afat 10 vjet, me vlerë 1,500 euro/muaj⁴⁰.*

Rezulton se këto pasuri kanë qenë të regjistruara në emër të z. G.L, përpara se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur të emëroreshin në detyrën e gjyqtarit e, konkretisht, referuar dokumenteve “Vërtetim nga dokumenti hipotekor”, të lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë⁴¹, konfirmohet se: (i) në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 16.2.2007, figuron e regjistruar në emër të z. G.L, pasuria nr. ***, e ndodhur në z. k. ***, me sipërfaqe trualli 450 m² dhe sipërfaqe

³⁷ Sipas dokumentit, “Prokurë e posaçme” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.9.2010 (ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së aneksi ***) nëpërmjet të cilit shtetasi G dhe V.L kanë emëruar si përfaqësuese të posaçme vajzën e tyre Ejona Lazellari, që në emër dhe për llogari të tyre t’i përfaqësojë në administrimin e pasurive të paluajtshme, duke i dhënë të drejtë të hyjë në bisedime me shoqërinë “****” sh.p.k., për dhënie me qira të tyre. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj prokure duket se ata i kanë përcaktuar edhe të drejta të tjera që kanë lidhje me administrimin e pasurive.

³⁸ Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2010, redaktuar nga noteri publik, znj. Dh.Q (ndodhur aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁹ Përfaqësuar me prokurë nga shtetasja L.D.

⁴⁰ Palët kanë nënshkruar procesverbalin e datës 11.10.2010, për dorëzimin e pasurive të dhëna/marra me qira.

⁴¹ Dokumente të depozituara nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

ndërtese 450 m², në adresën “****”, ndodhur në rrugën “****”; (ii) në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 6.6.2008, figuron e regjistruar në emër të z. G.L, pasuria nr. ***, e ndodhur në z. k. ***, truall me sipërfaqe 629 m², rruga “****”; (iii) në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 29.4.2008, figuron e regjistruar në emër të z. G.L, pasuria nr. ***, e ndodhur në z. k. ***, truall me sipërfaqe 243 m², rruga “****”.

Konstatohet se në datën 4.8.2014 është bërë revokimi i kontratës së qirasë⁴² (të referuar si më sipër), ku palët kanë deklaruar zgjidhjen me mirëkuptim, përfundimin e efekteve të kontratës së qirasë, si edhe se nuk kanë detyrime ndërmjet tyre.

Raiffeisen Bank⁴³ konfirmon se shtetasi G. L ka pasur llogari në monedhën euro, nga verifikimi i së cilës rezulton se për periudhën 2011 – 2014 janë kryer disa transfertat periodike – kreditime llogarie nga shoqëria “****” sh.p.k., me përshkrimin “Për pagesën e qirasë”, në vlerë totale në shumën 49,357 euro, nga ku konstatohet se: (i) për vitin 2011 është kredituar vlera 16,607 euro; (ii) për vitin 2012 është kredituar vlera 15,520 euro; (iii) për vitin 2013 është kredituar vlera 12,100 euro; (iv) për vitin 2014 është kredituar vlera 5,400 euro. Në vijim të verifikimit të lëvizjeve të kësaj llogarie konfirmohet se gjatë vitit 2014 subjekti i rivlerësimit ka kryer 14 tërheqje *cash*, në total tërhequr *cash* vlera 8,346 euro.

Sa më sipër, konfirmohet se shuma prej 8,346 euro, e deklaruar nga subjekti në DIPP/2014, ka si burim të ardhurat nga qiraja, të kredituara nga shoqëria “****” sh.p.k., në llogarinë bankare të babait të subjektit, z. G.L.

Sa i përket provueshmërisë së pagesës së detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga familjarët e subjektit si rezultat i marrëdhënies së qiradhënies, Komisioni konstaton se dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka depozituar dokumentacionin bankar nga Raiffeisen Bank⁴⁴, si vijon: (i) mandatpagesë datë 23.3.2012, “Derdhje për Tatim-Taksa (pa deklaratë tatimore)”, në shumën 252,000 lekë, me urdhërues G.L, përfitues Dega e Tatim-Taksave Tiranë, me përshkrimin “G.L tat. qiraje viti 2011, 23.3.2012”, me nënshkrues në cilësinë e klientit, L.D (identifikuar si përfaqësuesja e shoqërisë “****” sh.p.k.); (ii) mandatpagesë e datës 27.11.2013, në shumën 196,000 lekë, me urdhërues shoqërinë “****” sh.p.k., përfitues Dega e Tatimeve Tiranë, me përshkrimin “10 përqind tatim qira janar – tetor 2013, NIPT ***, për G.L”; (iii) mandatpagesë datë 8.1.2014, në shumën 42,000 lekë, me urdhërues shoqërinë “****” sh.p.k., me përshkrimin “10 përqind tatim qira nëntor – dhjetor 13, NIPT ***, për G.L”; (iv) mandatpagesë datë 22.4.2014, në shumën 63,000 lekë, me urdhërues shoqërinë “****” sh.p.k., me përshkrimin “10 përqind, tatim 3 muaj 2014, për G.L, NIPT ***”.

Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se babai/familja e subjektit ka/kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht dhurimin e shumës prej 8,346 euro, të evidentuar si të tërhequr prej subjektit nga llogaria e babait të saj gjatë vitit 2014, deklaruar si pasuri në seksionin përkatës të DIPP/2014, si dhe deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* si një nga burimet e krijimit të pasurisë së llojit likuiditet *cash*, në shumën 10,000 euro.

iii. Të ardhurat nga puna e babait në SHBA

Komisioni konstatoi se në DIPP/2014, në seksionin “Ndryshimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar se gjatë vitit 2014 ka tërhequr nga llogaria bankare në Raiffeisen Bank e klientit G.L, ku ka pasur autorizim për tërheqjen e shumave, shumën 7,000

⁴² Referojuni dokumentit noterial “Deklaratë për revokim kontrate” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.8.2014, redaktuar nga noteri publik, znj. Dh.Q, ndodhur në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴³ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.2.2021, e Raiffeisen Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.2.2021.

⁴⁴ Dokumentacion i ndodhur në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

USD. Gjithashtu, deklararon se në këtë llogari gjatë vitit 2014 ka derdhur shumën 1,600 USD. Në referim të deklarimeve të bëra nga subjekti ndër vite në ILDKPKI dhe shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ duket se në fund të vitit 2014 ajo ka disponuar si pasuri në gjendje *cash* edhe shumën në valutë prej 5,400 USD.

Gjithashtu, siç u evidentua më sipër, rezulton se nëpërmjet deklaratës së nënshkruar në datën 17.10.2016, para noterit publik në SHBA, shteti New Jersey, babai i subjektit, z. G.L, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“...Shumat e parave në euro dhe USD, të cilat kanë qenë objekt i deklaratimit të pasurisë nga vajza e tij, për të cilat ajo ka pasur të drejtën e administrimit dhe tërheqjes dhe të cilat kanë rrjedhur si rezultat i Kontratës së Qirasë lidhur me subjektin “***” sh.p.k. dhe transfertat nga të ardhurat familjare në SHBA, si dhe nga derdhjet e kryera në llogarinë e tij rrjedhëse në Raiffeisen Bank, konsiderohen pjesë e pasurisë së vajzës, Ejona Lazellari, pa asnjë kufizim tagrash pronësie duke u zhveshur ai nga çfarëdo e drejtë apo pretendim në lidhje me këto shuma”*.

Sa më sipër, bazuar në pikën 14 të nenit 3 dhe në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi G.L bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës 5,400 USD, deklaruar nga subjekti në DIPP/2014, konfirmuar si shumë e dhuruar prej tij.

Raiffeisen Bank⁴⁵ konfirmon se shtetasi G.L ka pasur një llogari në monedhën dollarë amerikanë (USD). Nga verifikimi i kësaj llogarie konstatohet se në datën 30.6.2014 është transferuar – kredituar shuma 6,991 USD, me përshkrimin “G.L”. Gjithashtu, Raiffeisen Bank⁴⁶ konfirmon se kjo transfertë është kryer nga një bankë në SHBA, prej shtetasis G.L. Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie rezulton se në datën 9.7.2014, subjekti i rivlerësimit tërheq shumën 7,000 USD, me përshkrimin “Tërheq Ejona Lazellari” dhe në datën 3.9.2014 ka depozituar shumën 1,600 USD me përshkrimin “Ejona Lazellari derdh në llogari”.

Sa i përket provueshmërisë së pagesës së detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga babai/familja i/e saj, si rezultat i marrëdhënies së punësimit në SHBA, Komisioni konstaton se me përgjigjet e pyetësorit nr. ***, subjekti ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor mbi të ardhurat e tyre nga puna për vitet 2013 – 2017⁴⁷. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se familjarët e subjektit kanë përfiturar të ardhura të konsiderueshme nga puna e kryer prej tyre përgjatë periudhës 2013 – 2017, në SHBA. Rezulton se sa i përket vitit 2014, vit në të cilin është kryer transfertat prej rreth 7,000 USD

⁴⁵ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.2.2021, e Raiffeisen Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.2.2021.

⁴⁶ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.12.2022, e Raiffeisen Bank, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 29.12.2022, pjesë e dosjes së hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për personin e lidhur, subjektin e rivlerësimit, z. L.F.

⁴⁷ Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. ***, dorëzuar pranë Komisionit më 22.9.2022, subjekti ka depozituar (1) transkript i llogarisë nga IRS për vitet 2015 – 2019; (2) transkript për pagën dhe të ardhurat për z. G.L, për vitin 2014; (3) dokument mbi pagën bruto (1,628 USD), ndalesat, pagën neto (1,135 USD), të z. G.L, pranë “***”, periudha deri më 15.9.2016; (4) deklaratë mbi të ardhurat personale të vitit 2015 (e tipit *joint* – e përbashkët për G dhe V.L); (5) formular mbi pagën dhe të ardhurat e z. G. L, viti 2015, punëdhënës “***”; (6) formular mbi pagën dhe të ardhurat e znj. V.L, viti 2015, punëdhënës “***”; (7) formular mbi pagën dhe të ardhurat e z. G.L, viti 2015, punëdhënës “***”; (8) deklaratë mbi të ardhurat personale të vitit 2014 (e tipit *joint* – e përbashkët për G dhe V.L); (9) formular mbi pagën dhe të ardhurat e znj. V.L, viti 2014, punëdhënës “***”; (10) formular mbi pagën dhe të ardhurat e z. G.L, viti 2014, punëdhënës “***”; (11) formular mbi pagën dhe të ardhurat e z. G.L, viti 2014, punëdhënës “***”; (12) deklaratë mbi të ardhurat personale të vitit 2013 (e tipit *joint* – e përbashkët për G dhe V.L); (13) formular mbi pagën dhe të ardhurat e shtetasve V dhe G.L, viti 2013, të ardhura nga “***”; (14) formular mbi pagën dhe të ardhurat e znj. V.L, viti 2013, përfiturar nga “***”; (15) formular mbi pagën dhe të ardhurat e z. G.L, viti 2013, përfiturar nga “***”; (16) dokument mbi pagën bruto (1,550 USD), ndalesat, pagën neto (1,138 USD), të z. G.L, pranë “***”, periudha deri më 30.9.2016.

(transfertë e kryer në shtator të këtij viti), të ardhurat vjetore bruto të prindërve të subjektit në SHBA kanë qenë në vlerën 73,747 USD⁴⁸. Referuar të dhënave statistikore⁴⁹, shpenzimet jetike gjatë vitit 2014, për një familje me 3 persona në SHBA, kanë qenë përcaktuar në vlerën 18,850 USD.

Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni vlerëson se babai/familja e subjektit ka/kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht dhurimin e shumës prej 5,400 USD, të evidentuar si të tërhequr prej subjektit nga llogaria e babait të saj gjatë vitit 2014, deklaruar si pasuri në seksionin përkatës të DIPP/2014, si dhe deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* si një nga burimet e krijimit të pasurisë së llojit likuiditet *cash*, në shumën 10,000 euro.

Sa më sipër, pas verifikimit dhe analizimit të deklarimeve të bëra mbi shtesat/pakësimet/gjendjet e likuiditeteve *cash* ndër vite, si edhe për burimin e krijimit të tyre, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e shumës prej 10,000 euro, të deklaruar si pasuri në gjendje likuiditetesh *cash* në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

❖ Deklarimi i pasurive veçmas nga personi i lidhur, z. L.F

28. Pasuria e llojit automjet tip “**”, me targë AA *****, blerë në datën 29.1.2016, në shumën 400,000 lekë.

28.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie, personi i lidhur ka deklaruar: *“Nga bashkëjetuesja, të ardhura të krijuara nga kontrata e qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2010, me qira mujore 1,500 euro në muaj për familjen, e cila është revokuar në datën 4.8.2014, me deklaratën nr. *** rep., nr. *** kol., ku nga llogaria bankare me nr. ***, e klientit G.L autorizohet nga babai tërheqja pranë Raiffeisen Bank, deklaratë konfirmuese e njësuar, lëshuar në datën 10.10.2016”.*

28.2 Deklarimi i kësaj pasurie në vite: Në DIPP/2016, personi i lidhur ka deklaruar: *“Makina “****”, me targë AA ****, ngjyrë gri, blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2016, në vlerën 400,000 lekë. Pjesa: 100%”. Lidhur me burimin e krijimit ka bërë të njëjtin deklaram si në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, cituar si më sipër.

28.3 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar.

29. Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

29.1 Referuar informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja⁵⁰, rezulton se në datën 29.1.2016 personi i lidhur ka blerë⁵¹ nga shoqëria “****” sh.p.k.⁵² automjetin tip “****”, me targë AA ***, vit prodhimi 2002, për çmimin 400,000 lekë, vlerë e cila deklarohet se është paguar para redaktimit të kontratës së shitblerjes, jashtë zyrës noteriale. Në vijim të verifikimit të dosjes së këtij automjeti rezulton se në datën 6.3.2019, subjekti ia ka shitur këtë automjet shtetasit E.N, për shumën 300,000 lekë.

⁴⁸ Bazuar vetëm në ndalesat e pasqyruara në deklaratën mbi të ardhurat personale të vitit 2014 (e tipit *joint* – e përbashkët për shtetasit G dhe V.L), të ardhurat neto duket të kenë qenë rreth 68,688 USD.

⁴⁹ www.census.gov/topics/income-poverty/poverty/guidance/poverty-footnotes/cps-historic-footnotes.html

⁵⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 28.7.2020, e DPSHTRR-së, pjesë e dosjes së hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për personin e lidhur, subjektin e rivlerësimit, L.F.

⁵¹ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.1.2016, redaktuar nga noteri publik, z. Th.B.

⁵² Shoqëria “****” sh.p.k. e kishte blerë më parë këtë automjet nga shtetasi V.Z, në datën 4.7.2007, për shumën 500,000 lekë.

29.2 Në trajtimin e deklarimeve të bëra në ILDKPKI dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ lidhur me shtesat/pakësimet/gjendjet e likuiditeteve *cash* ndër vite, Komisioni, ndër të tjera, konstatoi se ajo ka deklaruar shtesën e likuiditeteve *cash* në valutë për vitin 2014, në shumën 8,346 euro, me burim krijimi të ardhurat e përfituara nga babai/familja e saj nga qiradhënia e disa pasurive të paluajtshme – shumë e konfirmuar si e tërhequr prej saj nga llogaria bankare e babait në Raiffeisen Bank (me autorizim), krijimi i së cilës rezultoi se provohet me dokumentacion justifikues ligjor.

29.3 Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat e pasurisë objekt vlerësimi, si edhe ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht likuidimin e çmimit të blerjes së këtij automjeti, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

30. Pasuria e llojit likuiditet – shumë të hollash në vlerën 1,000 euro

30.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie personi i lidhur ka deklaruar të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****”.

30.2 Konkluzioni i ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar.

30.3 Deklarimi i bërë ndër vite mbi likuiditetet *cash*

Nga verifikimi i deklaratës së interesave privatë para fillimit të detyrës dhe DIPP-ve të viteve 2010 – 2014 nuk rezulton që personi i lidhur të ketë deklaruar shtesa/pakësime/gjendje likuiditetesh *cash*. Komisioni konstaton se në DIPP/2015, në rubrikën “Ndryshimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, personi i lidhur ka deklaruar: “*Të ardhura të krijuara nga shitja e automjetit me kontratën me nr. *** kol., nr. *** rep., datë 8.10.2015. Vlera: 1,000 euro*”.

30.4 Gjatë hetimit administrativ të kryer ndaj tij, personi i lidhur ka konfirmuar se shuma prej 1,000 euro, e deklaruar në rubrikën e cituar më lart, ka të bëjë me shtim likuiditetesh *cash*. Gjithashtu, rezulton se në DIPP/2016, personi i lidhur nuk ka deklaruar shtesa apo pakësime të likuiditeteve gjendje *cash*.

31. Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

31.1 Komisioni konstaton se personi i lidhur nuk ka deklaruar saktë mbi mënyrën e disponimit të kësaj pasurie. Por, nga ana tjetër, pas verifikimit dhe analizimit të dokumentacionit bankar të administruar në dosje, si edhe deklarimeve të bëra nga subjekti ndër vite në ILDKPKI, duket se vlera prej 1,000 euro pretendohet se disponohet si pasuri e llojit likuiditet në gjendje *cash* në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

31.2 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj shume, Komisioni konstaton se në DIPP/2012, personi i lidhur ka deklaruar kontratë blerjeje automjeti, në vlerën 1,500 euro dhe si dokument justifikues ka referuar kontratë shitblerjeje datë (e palexueshme), viti 2012.

31.3 Referuar dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja⁵³, rezulton se personi i lidhur, me kontratën e datës 10.12.2012, ka blerë nga shtetasi R.F automjetin tip “****”, me targë AA***, vit prodhimi 2001, në vlerën 1,500 euro⁵⁴.

31.4 Gjatë hetimit administrativ të kryer ndaj tij, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, personi i lidhur ka deklaruar se si burim të ardhurash për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer kursimet nga paga e gjyqtarit dhe shuma e kredisë në vlerën 300,000 lekë, e përfituar në prill të vitit 2012. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar rezulton e provuar se në datën 8.5.2012,

⁵³ Shkresë nr. *** prot., datë 28.7.2020, e DPSHTRR-së, pjesë e dosjes së hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për personin e lidhur, subjektin e rivlerësimit, z. L.F.

⁵⁴ Rezulton se shitësi R.F e kishte blerë këtë automjet në datën 24.5.2002, për çmimin 200,000 lekë.

në llogarinë e personit të lidhur në Tirana Bank është disbursuar kredia në shumën 300,000 lekë, shumë e cila është tërhequr plotësisht deri në datën 31.5.2012.

31.5 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje dhe deklaratimet e bëra nga personi i lidhur, Komisioni kreu analizën e financiare me qëllim evidentimin e mundësisë së personit të lidhur, për likuidimin në datën 10.12.2012, të çmimit të blerjes së automjetit tip “****”, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 3

Përshkrim	Vlerat në lekë
Automjet tip “****”, vit prodhimi 2001, targë AA *** (subjekti)	209,580
Shtim/pakësim likuiditete bankë ⁵⁵	146,752
Total pasuri	356,332
Kredi konsumatore Tirana Bank, 300.000 lekë, datë 8.5.2012	300,000
Total detyrime	300,000
Të ardhura nga pagat e subjektit ⁵⁶	864,389
Total të ardhura	864,389
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI – INSTAT ⁵⁷	132,798
Shpenzime qiraje në Vlorë (subjekti)	120,000
Shpenzime për shlyerjen e kredisë pranë ProCredit Bank (interes, principal, komisione etj.)	90,962
Shpenzime kredia e marrë pranë Tirana Bank	300,000
Shpenzime për shlyerjen e kredisë pranë Tirana Bank (interes, principal, komisione etj.)	79,929
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	44,871
Total shpenzime	768,560
Balanca e fondeve (të ardhura + detyrime - total pasuri - shpenzime)	39,497

31.6 Referuar të dhënave të analizës financiare Komisioni konstaton se personi i lidhur ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht blerjen e automjetit tip “****”, në dhjetor të vitit 2012. Nga ana tjetër, rezulton e provuar se në datën 8.10.2015, personi i lidhur L.F ia shet⁵⁸ këtë automjet shtetasit R.F, për çmimin 1,000 euro.

31.7 Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se personi i lidhur ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e shumës prej 1,000 euro, të deklaruar si gjendje likuiditetesh *cash* në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

32. Bashkëpronësia e personit të lidhur në pasurinë e llojit arë me sipërfaqe 4,600 m²

32.1 Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Drejtoria Kamëz Vorë⁵⁹ rezulton se sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi (AMTP) të datës 3.5.1996, shtetasi A.S.F (babai i personit të lidhur), në cilësinë e kryetarit të familjes bujqësore, bazuar në ligjin nr. 7501/1991, ka përfituar pasurinë e llojit tokë arë me sipërfaqe 5,600 m², e cila është regjistruar në regjistrat hipotekorë me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, Tiranë. Më pas, pasurinë e mësipërme e ka ndarë në tri pasuri të tjera, konkretisht në pasuritë: (i) nr. ***⁶⁰, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sipërfaqe 3,000 m²; (ii) nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sipërfaqe 1,000 m²; (iii) nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sipërfaqe 1,600 m². Me aktin e shitblerjes nr. *** rep., nr.

⁵⁵ Diferenca midis gjendjes së llogarive të personit të lidhur në datën 10.12.2012 me atë të datës 31.12.2011.

⁵⁶ Pagat e kredituara në Tirana Bank dhe në Credins Bank për periudhën 1.1.2012 – 10.12.2012.

⁵⁷ Përlllogaritur për 11.3 muaj.

⁵⁸ Kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., *** kol., datë 8.10.2015, redaktuar nga noteri publik, znj. M.I.

⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.9.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Kamëz-Vorë, pjesë e dosjes së hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për personin e lidhur, subjektin e rivlerësimit, z. L. F

⁶⁰ Rezulton se kjo pasuri është ndarë në 3 parcela me nga 1.000 m² e, konkretisht, në pasuritë: (i) nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, (ii) nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, (iii) nr. ***, vol. ***, f. ***,

*** kol., datë 12.8.2010, shtetasit A.F, V.M, R.F dhe L.F i kanë shitur shtetasit M. A pasurinë nr. ***, z. k. ***, me sipërfaqe 1,000 m², kundrejt çmimit prej 626,000 lekësh.

32.2 Komisioni konstaton se personi i lidhur, në cilësinë e anëtarit të familjes bujqësore, është bashkëpronar në disa parcela/tokë bujqësore të llojit arë me sipërfaqe totale 4,600 m², porse nuk i ka deklaruar këto pasuri në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Gjithashtu, nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituar ndër vite në ILDKPKI, rezulton se personi i lidhur nuk i ka deklaruar pasuritë e mësipërme dhe/apo pjesën e tij takuese mbi to.

32.3 Pasi Komisioni e ka pyetur personin e lidhur mbi këtë mosdeklarim⁶¹, ai ka parashtruar sa vijon:

...Në lidhje me pasuritë e sipërcituara... nuk është informuar për AMTP-në e datës 3.5.1996 (mosha 10 vjeç në këtë periudhë). Këto pasuri nuk i ka poseduar, administruar apo gëzuar ndonjëherë. Informacionin në lidhje me ekstremitetet e pasurisë e ka marrë nëpërmjet pyetjeve nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

*...Në lidhje me nënshkrimin e kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.8.2010, bën me dije se kjo kontratë është nënshkruar para emërimit përfundimtar (propozimi për emërim datë 14.11.2011) dhe emërimit në stazh profesional shtator 2010 – korrik 2011. Pra, kjo pasuri është transferuar para emërimit në detyrë dhe ai nuk e gëzonte cilësinë e pronarit në kohën e deklaramit. Babai tij, z. A.S.F, ka ndërruar jetë në tetor 2018, situatë e cila nuk i jep mundësi të japë shpjegime të detajuara në lidhje me këto pasuri.*

*...Në lidhje me këto pasuri... bën me dije se as nëna e tij V.M, as vëllai R.F nuk janë në dijeni mbi ekzistencën e bashkëpronësisë mbi pasuritë: (i) nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 3,000 m²; (ii) nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 1,600 m². Gjithashtu, bën me dije se mungesa e informacionit ka sjellë që të mos kenë asnjë dijeni mbi vendndodhjen konkrete, sipërfaqen, situatën faktike. Këto pasuri nuk i kanë poseduar apo administruar, pavarësisht gjendjes juridike të parashtruar...*

32.4 Komisioni vëren se referuar pikës 2 të VKM-së Nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, toka bujqësore është ndarë për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes familjare në datën 1.8.1991. Në këto kushte, bazuar në nenet 4, 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, shtojcën 1 të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimin nr. 4095/2016 të ILDKPKI-së, personi i lidhur detyrohej të deklaronte pasuritë e paluajtshme, të përfituara në zbatim të ligjit nr. 7501/1991, si dhe pjesën e tij takuese mbi to.

32.5 Gjithsesi, duke qenë se rezulton e provuar se pjesa takuese mbi këtë/këto pasuri është përfitur nga personi i lidhur në moshë të mitur (para bashkëjetesës dhe lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit), pasuri e fituar me ligj, si edhe në konsideratë të faktit se personi i lidhur është vetë subjekt rivlerësimi, për të cilin është kryer një proces i pavarur/i ndarë, nga një trupë tjetër gjyqësore, Komisioni çmon se ky mosdeklarim nuk mund të ndikojë në procesin e rivlerësimit të gjyqtarës Ejona Lazellari.

33. Analiza financiare

33.1 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaramet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe në përgjigjet e pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për periudhën

⁶¹ I pyetur personi i lidhur gjatë hetimit administrativ të kryer ndaj tij – në cilësinë e subjektit të rivlerësimit.

21.10.2013 – 31.12.2013⁶² dhe vitet 2014 – 2016⁶³, nga ku rezultoi se ata kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin/shitesat e pasurive, si edhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për periudhat objekt analize⁶⁴.

34. Konkluzion mbi vlerësimin e pasurisë

34.1 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

34.2 Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ajo ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj dhe personave të lidhur. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

34.3 Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaratimet periodike vjetore të interesave privatë nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

34.4 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësia.

34.5 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

35. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ajo ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

36. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës⁶⁵ së subjektit të rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii)

⁶² Për periudhën 21.11.2013 – 31.12.2013, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit.

⁶³ Për periudhën 2014 – 2016, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet, për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëjetuesin e saj, personin e lidhur L.F.

⁶⁴ Referojuni tabelës përmbledhëse të analizës së treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, Aneks ***, pjesë e këtij vendimi.

⁶⁵ Raporti nr. *** prot., datë 31.10.2017, i DSIK-së.

për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të kimit të organizuar.

37. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari.

38. Komisioni ka kërkuar nga AKSIK-ja⁶⁶ përditësimin e raportit mbi kontrollin e figurës me informacione reja të mundshme të përcjella rishtazi nga organet e verifikimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari. AKSIK-ja ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit shkresat e administruara nga institucionet e verifikimit mbas përpilimit të raportit mbi kontrollin e figurës, për këtë subjekt. Nga verifikimi i tyre nuk rezulton të jenë përcjellë informacione apo sinjalizime mbi kontakte të papërshtatshme dhe/apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, në veprimtari të kundërligjshme.

39. Në këtë kontekst, AKSIK-ja nuk ka përpiluar një raport të ri për subjektin e rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, porse me vendimin nr. ***, datë 5.6.2023, të KDZH-së ka deklasifikuar plotësisht raportin mbi kontrollin e figurës të dërguar më parë në Komision, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës⁶⁷.

40. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

41. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

42. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, fillimin në detyrë në gjyqësor e ka në datën 21.10.2013, kur është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (për periudhën e stazhit profesional). Në periudhën korrik 2014 – shtator 2015, subjekti i rivlerësimit ka qenë në pritje të emërimit përfundimtar si gjyqtare. Në datën 25.9.2015 është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, detyrë të cilën e ushtron edhe aktualisht (gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier).

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

43. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), si organi ndihmës për vlerësimin profesional të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2023, e Komisionit.

⁶⁷ Dërguar raporti i kontrollit të figurës, i deklasifikuar plotësisht, me shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2023, të AKSIK-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.6.2023.

44. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

45. Referuar raportit, subjekti i rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, ka shfaqur aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, arsyetimit ligjor dhe ka njohuri të mira të procedurave të gjyqimit të çështjeve gjyqësore. Gjithashtu, konstatohet se kjo gjyqtare ka aftësi për të përballuar ngarjesën në punë, si dhe për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjithashtu, nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

46. Por, gjithsesi nga vëzhgimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti dhe pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, në raport janë listuar disa gjetje që lidhen me: (i) raste kur gjyqtarja Lazellari nuk shprehet për kërkesat e palëve; (ii) zgjatje të panevojshme të arsyetimit të vendimeve për çështje me karakter të përgjithshëm, duke zbehur rëndësinë e zgjidhjes së çështjes; (iii) në një rast kohëzgjatja e gjyqimit ka tejkaluar afatin standard dhe; (iv) në një rast është tejkaluar me 2 ditë afati ligjor për arsyetimin e vendimit, gjetje e cila nuk vlerësohet domethënëse.

47. Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit të aftësive profesionale “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Ejona Lazellari nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj gjyqtares Ejona Lazellari të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

48. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësive profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese dhe atij të administruar në funksion të hetimit të kryer; si dhe (iii) kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

49. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së, nga ku duket se nuk konstatohen problematika thelbësore lidhur me kriterin e vlerësimit profesional. Por, nga ana tjetër, Komisioni vlerëson se qëndrojnë gjetjet e evidentuara në raportin për analizën e aftësive profesionale, për të cilat subjektit iu kërkuan shpjegime me dërgimin e rezultateve të hetimit.

50. Në vlerësimin e gjyqtares Lazellari u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 5 denoncime të depozituara nga publiku në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Pas administrimit të fashikujve të plotë gjyqësorë dhe materialeve të tjera që lidhen me çështjet

objekt denoncimi⁶⁸ dhe verifikimit, analizimit e shqyrtimit të tyre në raport me pretendimet e ngritura nga denoncuesit në ankesat e depozituara, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të provojë me dokumentacion justifikues ligjor mbi veprimet e kryera prej saj në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore që lidhen me 4 denoncime të depozituara nga publiku, përkatësisht për denoncimet/ankesat e bëra nga shtetasit S.A⁶⁹, L.B⁷⁰, N.M⁷¹ dhe K.M⁷².

51. Më konkretisht, lidhur me denoncimin e shtetasit S.A, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime mbi faktin e konstatuar se Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (gjyqtarja Lazellari, e cila kishte vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë) dhe pushimin e gjykimit, pasi ka evidentuar edhe shkelje të natyrës procedurale.

51.1 Në lidhje me disponimin e rrëzimit të kërkesëpadsisë dhe jo pushimin e gjykimit, me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se kjo çështje ka qenë e regjistruar në datën 24.12.2015. Neni 299 i Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton rastet kur pushon çështja, ka ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, konkretisht shkronja “c”, e cila përcakton se *një nga rastet e pushimit është kur gjykata konstaton se çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si edhe kur padia nuk mund të ngrihet ose gjykimi nuk mund të vazhdojë*. Kur këto shkaqe konstatohen nga gjykatat më të larta, ato prishin vendimin e gjykatave më të ulëta dhe vendosin pushimin e gjykimit. Ndryshimi i kësaj pike, automatikisht ka shfuqizuar nenin 468 (*e cila parashikonte se Gjykata e Apelit kur konstaton se çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si dhe kur padia nuk mund të ngrihet ose gjykimi nuk mund të vazhdojë, prish vendimin edhe vendos vetë pushimin e gjykimit të çështjes*), dispozitë e cila në praktikë ka pasur diskutime, nëse pushimi i çështjes me shkakun se padia nuk mund të ngrihet është tagër vetëm e Gjykatës së Apelit apo edhe e Gjykatës së Shkallës së Parë (duke qenë se ka qenë i pozicionuar në kreun II “Mbi paraqitjen e ankimit dhe gjykimin në Apel”).

51.2 Në vijim ka argumentuar se dispozitat tranzitore parashikojnë se çështjet civile, që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji në gjykatën e shkallës së parë, në Gjykatën e Apelit ose në Gjykatën e Lartë, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesëpadsisë. Pra, koha e regjistrimit është data 24.12.2015, kohë kur ishte në fuqi neni 468 i Kodit të Procedurës Civile. Neni 299 me ndryshimet e tij, pavarësisht se ka hyrë në fuqi në kohën e shpalljes së vendimit, nuk mund të zbatohet për shkak të veprimit në kohë të ligjit procedural civil.

51.3 Gjithashtu, ka referuar se arsyeja e rrëzimit nga gjykata e shkallës së parë është e njëjtë me atë të Gjykatës së Apelit, e cila ka disponuar me pushimin e gjykimit, konkretisht kërkimi në mënyrë të pavarur të pavlefshmërisë absolute pa kërkuar zgjidhjen e pasojave. Mënyra e disponimit është thjesht një çështje teknike e ligjit, *problematikës në lidhje me disponimin nga shkalla e parë me vendim pushimi për rastet kur padia nuk mund të ngrihet apo nuk mund të vazhdojë*, situatë e cila është zgjidhur me ndryshimet e nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile.

⁶⁸ Materialet e përcjella me: (i) shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier me, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.5.2023; (ii) shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.5.2023; (iii) shkresën nr. ***prot., datë 2.6.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 6.6.2023; dhe (iv) shkresën nr. *** prot., datë 9.6.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.6.2023.

⁶⁹ (i) Ankesa nr. *** prot., datë 13.12.2017; (ii) ankesa nr. *** prot., datë 14.12.2017; (iii) ankesa nr. *** prot., datë 19.12.2017.

⁷⁰ Ankesa nr. *** prot., datë 18.5.2018.

⁷¹ Ankesa nr. *** prot., datë 17.12.2019.

⁷² Ankesa nr. *** prot., datë 17.12.2019.

52. Sa i përket denoncimit të bërë nga shtetasi L.B, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime se pse nuk janë gjykuar brenda afateve dy çështje civile, në të cilat denoncuesi shfaqet si palë ndërgjyqëse.

52.1 Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se për çështjen gjyqësore që lidhet me vendimin civil nr. ***, datë 7.5.2018, referuar procesverbaleve gjyqësore, rezulton se seancat janë shtyrë për shkak të palës paditëse: nuk ka paraqitur kopje të kërkesëpadisë (pasi është pretenduar nga palët që provat dhe kërkesëpadiat janë në dosjen e pushuar, ndërkohë padia e re është ndryshuar); adresës së palës së paditur, ekstrakt i QKB-së, mungesës së njoftimeve efektive, mungesës së konfirmimit të njoftimit me shpallje; konstatimit me të meta në lidhje me objektin e padisë (për shkak të vendimit unifikues) dhe parapagimin e tarifës gjyqësore; kërkesës për shtyrje për shkak të mosparaqitjes së avokatit.

52.2 Ndërsa, për çështjen gjyqësore që lidhet me vendimin nr. ***, datë 21.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, referon se kjo dosje është regjistruar në datën 3.6.2015, porse është shortuar për gjyqtare Ejona Lazellari në datën 2.11.2016. Referuar regjistrin të veprimeve, kjo dosje i është caktuar fillimisht gjyqtarës M.D, e cila e ka dorëzuar për shkak të lejes së lindjes, është rishortuar dhe i është caktuar gjyqtarës A.D, e cila e ka dorëzuar për shkak të lejes së lindjes, është rishortuar dhe i është caktuar gjyqtarit E.S, i cili është përjashtuar. Në përfundim është rishortuar dhe marrë në dorëzim nga subjekti, në datën 2.11.2016. Referuar procesverbaleve gjyqësore, rezulton se seancat janë shtyrë me kërkesë të palës paditëse për paraqitjen e provave, përfaqësimin nga avokati, kërkesën për rregullimin e ndërgjyqësisë (shtim në cilësinë e paditësit apo ndërhyrësit kryesorë sipas orientimeve të gjykatës), pra në asnjë rast për shkak të gjykatës. Kjo dosje është pushuar për shkak të heqjes dorë dhe është administruar në dosjen civile që i përket vendimit civil nr. ***, datë 7.5.2018, me qëllim që palët të mos riparaqesin edhe një herë provat dhe mos kryejnë shpenzimet.

52.3 Në mbështetje të prapësimeve të saj, subjekti ka depozituar si dokumentacion shtesë provues: (i) fletëshortin; (ii) regjistrin e veprimeve; (iii) procesverbale; (iv) fletëregjistrin të kryesekretares; dhe (v) kapak dosjeje.

53. Pas verifikimit të ankesës së bërë nga shtetasi N.M, identifikuar si avokat i palës së paditur për çështjen civile me objekt “Zgjidhjen e martesës etj.”, rezulton se denoncuesi pretendon se ka pasur fshirje të regjistrimit audio të shpalljes së vendimit, duke hedhur dyshime se kjo ka ndodhur për shkak se ka pasur ndryshim të dispozitivit të vendimit përfundimtar, të shpallur në seancë gjyqësore me dispozitivin e vendimit të arsyetuar të njoftuar, pra se ka ndodhur falsifikim vendimi. Gjithashtu, denoncuesi pretendon se gjyqtarja Lazellari, megjithëse ka pranuar çdo kërkesë të bërë nga pala paditëse në gjykim, në dispozitivin e vendimit ka referuar se ka pranuar pjesërisht kërkesëpadinë.

53.1 Nga shqyrtimi i materialeve të dosjes gjyqësore objekt denoncimi, Komisioni konstatoi se momenti i shpalljes së vendimit është i padokumentuar me regjistrim audio, në kundërshtim me funksionin e transparencës dhe të solemnitetit në gjykim. Gjithashtu, nga shqyrtimi i fashikullit gjyqësor dhe vendimit të dhënë nuk duket të jenë referuar/evidentuar se cila pjesë e kërkesëpadisë është pranuar dhe cila pjesë e saj nuk është pranuar.

53.2 Pas kalimit të barrës së provës, me dërgimin e prapësimeve lidhur me pretendimet e ngritura në këtë denoncim, gjetjet dhe kërkesat e bëra nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar sa vijon:

- Në lidhje me pretendimet mbi mbajtjen e procesit ka argumentuar se nga interpretimi historik i nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile konstatohet se ligjvënësi, në ish-nenin 118 të Kodit

të Procedurës Civile⁷³, parashikonte detyrimin e kryetarit të seancës gjyqësore, pra të gjyqtarit të çështjes, që të vistonte dhe të nënshkruante procesverbalin e seancës gjyqësore, bashkë me sekretaren gjyqësore, ndërkohë, në nenin 118 aktual të Kodit të Procedurës Civile⁷⁴, për shkak të ndryshimit të formës së mbajtjes së procesverbalit të seancës gjyqësore, nga ai me dorëshkrim në audio apo audio-viziv, parashikohet vetëm detyrimi i kryetarit të seancës gjyqësore që të sigurohet për mbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore audio, veprim i cili kryhet nga sekretaria gjyqësore. Mbi këtë bazë ligjore ka dalë edhe Udhëzimi i ministrit të Drejtësisë nr. 353, datë 3.9.2013, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”. Nga sa më sipër, ndryshimet legjislative të realizuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, me anë të ligjit nr. 122/2013, kanë sjellë një regjim të ri juridik në lidhje me formën e mbajtjes e procesverbalit të seancës gjyqësore, si dhe subjektit i cili e mban atë, duke u parashikuar mbajtja e procesverbalit në formën audio, nga ana e sekretares gjyqësore, e cila e nënshkruan atë në fund të çdo flete, duke u përjashtuar kështu detyrimi i gjyqtarit për vistimin e procesverbalit të seancës gjyqësore dhe nënshkrimin e tij në fund të çdo flete. Parë nga ky këndvështrim, ligjvënësi, në nenin 118/1 të Kodit të Procedurës Civile, ka parashikuar vetëm detyrimin e gjyqtarit për të siguruar mbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore në formën audio apo audio-vizive, veprim i cili kryhet nga sekretaria gjyqësore, e cila ka detyrimin e nënshkrimit të tij në fund të çdo flete. Referuar transkriptimit të procesverbalit audio, rezulton se është kryer shënimi, riçelet seanca, shpallet vendimi, fakt i cili provon se seanca është urdhëruar të kryhet audio, por problemet në lidhje me dëgjimin e saj janë të natyrës teknike të sistemit audio. Nga momenti kur ndërpritet audio dhe riçelet seanca, rezulton se ndryshon minutazhi, pra nga 9.57.13 sek. në 9.58.42 sek.

- *Në lidhje me pretendimet mbi disponimet e gjykatës*, referon se vendimi nr. ***, datë 23.10.2019, ka marrë formë të prerë në datën 21.11.2019, pasi nuk është ankimuar, pra, palët kanë marrë dijeni dhe nuk e kanë ankimuar, edhe pse kanë pasur të drejtë brenda afatit 15-ditor, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Gjithashtu, sqaron se në pikën 1 të kërkesëpadisë, gjykata ka disponuar me pranimin pjesërisht, fakt i cili provon se gjykata nuk i ka pranuar tërësisht kërkesimet e palëve ndërgjyqëse në gjykim. Sa i përket pretendimeve mbi falsifikimin, gjykon se ato janë fyese, pasi edhe në rast se do të kishte një gabim material në vendim, Kodi i Procedurës Civile parashikon korrigjimin e gabimeve të vendimeve gjyqësore.

53.3 Në përfundim të shpjegimeve lidhur me këtë denoncim, subjekti i rivlerësimit ka theksuar se asnjë gjyqtar nuk ndërhyr dhe nuk kryen veprime në sistemin audio, pasi është tagër ekskluziv i sekretares gjyqësore. Aktualisht, sot, në cilësinë e gjyqtarit, ajo nuk ka njohuri në hapjen e sistemit audio dhe regjistrimin e çështjeve, me përjashtim të dëgjimit të seancave audio, kur duhet të pasqyrohen të dhëna në vendime gjyqësore.

54. Ndërsa, sa i përket ankesës së depozituar nga avokati K.M, në shqyrtim të të gjitha pretendimeve të ngritura nga ky denoncues, Komisioni konstatoi se në arsyetimin e vendimit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (gjyqtarja Ejona Lazellari), ndër të tjera, ka referuar edhe nenin 468 të Kodit të Procedurës Civile, nen i cili ka qenë i shfuqizuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, duke i kërkuar subjektit të japë shpjegime mbi këtë konstatim.

⁷³ Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001.

⁷⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 122/2013.

54.1 Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se citimi i nenit 468 të Kodit të Procedurës Civile ndodhet në referimin që gjykata i bën vendimit nr. 270/2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendim i cili sqaron institutin e “padisë që nuk mund të ngrihet”, institut i cili është zgjeruar në zbatim, referuar shfuqizimit të nenit 468 dhe ndryshimit të nenit 299/c të Kodit të Procedurës Civile. Pra, ky institut nuk është shfuqizuar, por është zgjeruar, duke u ripozicionuar në Kodin e Procedurës Civile.

54.2 Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet prapësimet e subjektit të rivlerësimit të shoqëruara me shpjegimet/argumentet dhe provat përkatëse, çmon se ajo ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse dhe në nivel ligjor sa i përket gjetjeve të evidentuara në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe mbi kërkesat dhe/apo gjetjet e evidentuara në trajtimin e problematikave të ngritura në denoncimet e publikut, ku nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, të tilla që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

55. Si përfundim, në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje të përsëritura e të qenësishme të natyrës procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, të tilla që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

56. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Ejona Lazellari, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 21.6.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Pamela QIRKO
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANEKS 1 – TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

Analiza financiare për vitet 2014 - 2016.	21.10.2013-31.12.2013	2014	2015	2016
A) Pasuri	14,154	7,413,383	488,309	-5,952,851
Apartament banimi në bashkëpronësi me bashkëjetuesin, blerë në dt.6.3.2014		7,700,000		
Automjet i markës ***, tip *** me targa TR ***në përdorim.				
Automjet i markës *** me targa AA ***, blerë nga b/shorti në datë 29.1.2016				400,000
Ndryshim likuiditeti	14,154	-286,617	488,309	-6,352,851
B) Detyrime	0	5,640,000	0	0
Kredi bankare për blerje pasurie të paluajtshme (OTP Bank)		5,640,000		
C) Pasuri neto (A-B)	14,154	1,773,383	488,309	-5,952,851
D) Të ardhura	144,571	4,148,174	2,273,020	2,032,015
Të ardhura nga paga e subjektit	101,001	976,835	979,108	1,052,201
Të ardhurat e subjektit nga magjistratura	43,570		37,400	
Të ardhura nga paga e personit të lidhur		980,726	990,422	979,814
Të ardhura nga babai i subjektit		1,783,014		
Të ardhura nga babai i subjektit		407,599		
Të ardhura nga shitja e automjetit ***, targë AA*** (personi i lidhur)			139,450	
Të ardhura nga prindërit dhe motra e subjektit			126,640	
E) Shpenzime	89,628	2,326,909	1,350,327	6,386,578
Shpenzime minimale jetike	23,504	439,996	448,552	470,184
Shpenzime për udhëtimi jashtë vendit	16,124	760,978	152,491	176,607
Shpenzime qiraje, subjekti rivlerësimi, Tiranë	50,000	50,000		
Shpenzime qiraje, personi lidhur, Vlorë		120,000	120,000	120,000
Shpenzime për arredim apartamenti në Tiranë		560,000	140,000	
Shpenzime shlyerje kredie (OTP Bank)		395,935	489,284	5,619,787
Balanca e fondeve (D-C-E)	40,789	47,883	434,383	1,598,287